



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 020/04 1371 dt. 12.01 2021

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Formimin e komisioni për vlerësimin e Dëmeve në Biznese dhe Ekonomitë Familjare nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera

- I.** Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e Dëmeve në Biznese dhe Ekonomitë Familjare nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, në Komunën e Drenasit janë:
1. Adhurim Hoxha - Kryetar,
 2. Asim Bujupi - Anëtar,
 3. Fitim Veliqi - Anëtar,
 4. Safet Hoxha - Anëtar,
 5. Shaban Dobra - Anëtar.
- II.** Detyrë e këtij Komisionit është të vlerësoj dëmet e shkaktuara në Biznese dhe Ekonomitë Familjare, pas vërshimeve të fundit në territorin e Komunës së Drenasit, respektivisht në Zonën e Qendrës së Drenasit, Çikatovë e Re, Strubullojë, Poklek i Ri dhe Poklek i Vjetër (për territorin tjetër është formuar komision tjetër), si dhe pas përfundimit të punës së tyre, të hartojë Raport me shkrim për vlerësimin e dëmit.
- III.** Komisioni për vlerësimin e dëmeve pas vërshimeve të fundit nga reshjet atmosferike, punën e tyre duhet të kryejnë me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim.
- IV.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: DSHPE-ja dhe DZHE-ja.
- V.** Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtareve të Komisionit;
- DSHPE-së;
- DZHE-së;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci